REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS VRHOVNI SUD KOSOVA
GJ.A-Su.A 184/2019
Dt: 31/05/2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më datë 30 maj 2019, me shumicë votash, miratoi këtë:

U DH Ë Z I M
PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË PERSONAVE TË DËNUAR

a) Procedura e transferimit të personave të dënuar nga Republika e Kosovës tek shteti tjetër si dhe transferimi i personave të dënuar nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës, zbatohet sipas kushteve të parapara me dispozita të Ligjit nr. 04/L-213 Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.

b) Sipas dispozitës së nenit 62. par. 1 të ligjit në fjalë, shprehimisht është paraparë se:" Ministri mund të lejoi transferimin e personit të dënuar nga shteti tjetër, në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës, me qëllim të vuajtjes së dënimit apo pjesës së mbetur të dënimit, me kusht që vepra penale për kryerjen e të cilës, personi është dënuar në shtetin dënues, është vepër penale edhe në bazë të ligjit vendor", ndërsa paragrafi 3.i këtij neni specifikon se: " nenet 56,59 dhe 60 të këtij ligji zbatohen *mutatis mutandis".*

c) Kërkesën për vlerësimin paraprak të kushteve ligjore të transferimit e ushtron Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa para dhënies së lejes ose pëlqimit për transferim të personit të dënuar nga ana e Ministrit, për plotësimin e kushteve të parapara ligjore, vendos gjykata kompetente, në fjalë.

A r s y e t i m

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, të Republikës së Kosovës, me parashtresën e datës 23.04.2019, i është drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës me kërkesë për dhënien e opinionit në lidhje me procedurat që duhet ndjekur lidhur me Transferimin e Personave të Dënuar. Në kërkesë është cekur se ka dy opinione të ndryshme në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN) të Ministrisë së Drejtësisë. Sipas opinionit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kërkohet që kjo gjykatë në mënyrë që t'i trajtojë kërkesat, fillimisht të jepet pëlqimi për transferim nga Ministri i Drejtësisë, sipas nenit 62 të ligjit të sipër-cekur, ndërsa opinioni i DBJN-së, është se nuk mund të jepet pëlqimi nga Ministri, pa vlerësimin e kushteve ligjore nga ana e Gjykatës, ngase, sipas nenit 62 të ligjit, duhet të zbatohen nenet 56,59 dhe 60 *mutatis mutandis,* kështu që paraprakisht, gjykata duhet të verifikojë nëse kërkesa është në përputhje me nenet e cekura më lartë e pastaj të jepet pëlqimi.

Gjykatës Supreme të Kosovës, krahas kërkesës i janë bashkangjitur edhe shkresat e komunikimit në mes të Departamentit dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, nga të cilat konstatohen opinionet e ndryshme me përmbajtje si më lartë.

Ligji nr.04/L-213 Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera. Për zbatimin e këtij ligji, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, më datë 28.02.2014 ka miratuar Udhëzuesin Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, të cilat janë rekomandime për gjykatat, prokurorit dhe autoritetet tjera.

Ligji Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, në Kreun IV ka rregulluar Transferimin e personave të dënuar dhe atë; nën-kreu I, parasheh procedurën për transferimin e personave të dënuar nga Republika e Kosovës tek shtetet tjera, ku në mes tjerash në nenin 56 ka paraparë kushtet për transferim, neni 59 kërkesën për transferim dhe dokumentet shtesë si dhe neni 60. rregullon procedurën e transferimit të personave të dënuar në bazë të urdhrit për depërtim apo dëbim.

Nën-kreu II, i këtij ligji ka paraparë rregullat e transferimit të personave të dënuar nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës, kësisoj neni 62. rregullon qëllimin dhe kushtet për transferim, paragrafi 1. parasheh se: "Ministri mund të lejoi transferimin e personit të dënuar nga shteti tjetër, në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës me qëllim të vuajtjes së dënimit apo pjesës së mbetur të dënimit, me kusht që vepra penale për kryerjen e të cilës, personi është dënuar në shtetin dënues, është vepër penale edhe në bazë të ligjit vendor " ndërsa paragrafi 3. specifikon se, nenet 56,59 dhe 60 të këtij ligji zbatohen *mutatis mutandis.*

Andaj, sipas interpretimit në seancën e përgjithshme të kësaj gjykate, dispozitat ligjore për transferimin e personave të dënuar nga Republika e Kosovës në shtetet tjera ose anasjelltas, nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës, vlejnë kushtet e njëjta që duhet plotësuar për një procedurë të rregullt për transferimin e personave të dënuar. Kësisoj, kërkesën për vlerësimin paraprak të kushteve ligjore të transferimit të personave të dënuar e ushtron Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila sipas ligjit, është e kompetencës ekskluzive, kështu që para dhënies së pëlqimit ose lejes për transferim të personit të dënuar nga ana e ministrit, gjykata vlerëson se a janë plotësuar kushtet ligjore, ngase, në të kundërtën do të ishte e panevojshme procedura e vlerësimit në gjykatë, sikur ministri të jepte lejen ose pëlqimin paraprak, pa ndonjë ekspertizë të organit kompetent (gjykatës).

Pra, në rastin konkret, kemi të bëjmë vetëm me procedurën e plotësimit të kushteve ligjore për transferim të personit të dënuar, do të thotë vlerësim i kushteve ligjore që një i dënuar duhet t'i plotësoi, për t'u transferuar, pastaj, nëse sigurohet leja për transferim nga ministri, i nënshtrohet vlerësimit të procedurës së ekzekutimit të dënimit të shqiptuar nga shteti i huaj dhe pas vlerësimit të të gjitha kritereve, i dënuari mund të transferohet në shtetin tonë.

(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 30 maj 2019)